

LIGJ
Nr. 39/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9774, DATË 12.7.2007 “PËR VLERËSIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”; emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”; emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Punës” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e punës” dhe emërtimi “Inspektorati i Kontrollit të Automjeteve” zëvendësohet me emërtimin “Struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë kontroll për zhurmën, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në fuqi.”.

Neni 2

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Vendimi i kontrollit

1. Pas kryerjes së kontrollit, vendimi merret në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektori ose zyrtari i ngarkuar me këtë funksion i strukturës përgjegjëse të pushtetit vendor që bën kontrollin. Në rast të konstatimit të shkeljeve, inspektori ose zyrtari cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë.

2. Rezultatet dhe vendimi i kontrollit u njoftohen subjektit të kontrolluar dhe organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet veprimtaria e kontrolluar. Një përmbledhje e vendimit të kontrollit vihet në dispozicion të publikut për 1 muaj, duke u depozituar në organin e qeverisjes vendore përkatëse.

3. Sipas nevojave të rastit, inspektori ose struktura përgjegjëse e pushtetit vendor, marrin masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 32 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga organet e kontrollit, të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, me dënim kryesor me gjobë si më poshtë:”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Krahas dënimit me gjobë, në varësi të dëmit që shkakton zhurma, vendoset edhe dënimi plotësues i mbylljes së përkohshme, derisa subjekti të marrë masat e nevojshme për eliminimin e saj, ose mbyllja e përhershme e burimit të zurmës.”.

Neni 4

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33
Ankimi

Ndaj vendimit të inspektorit ose të zyrtarit të strukturës përgjegjëse të pushtetit vendor mund të bëhet ankimi në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7998, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani